



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 334/1 Prot.

Tiranë, më 24.02.2021

**V E N D I M**

Nr.16, datë 24.02.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë të procedurës së lirimit nga shërbimi civil për shkak të ligjit, të nëpunësit \*\*\*\*\* , në detyrën “*Specialist Auditi*”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Maliq.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar; nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së procesit të lirimit nga detyra shkak të ligjit, të nëpunësit \*\*\*\*\* , i punësuar më parë në pozicionin e punës *Specialist Auditi*”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Maliq,

**Vërej se:**

Shtetasi \*\*\*\*\* , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 933 prot., datë 21.12.2020 “*Kërkesë për interpretim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe asaj me nr. 933/1 prot., datë 31.12.2020 “Dërgim dokumentacioni”, ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje në zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, gjatë kryerjes së procesit administrativ të lirimit të tij nga detyra dhe përfundimit të marrëdhënies së punësimit, komunikuar me vendimin nr. 33, datë 01.09.2020, “*Për lirimin nga shërbimi civil i nëpunësit civil \*\*\*\*\**” të Kryetarit të Bashkisë Maliq.*

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, si dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, nëpërmjet shkresës me nr. 47 prot., datë 12.01.2021, “*Kërkim dokumentacioni për verifikimin e kërkesës, së paraqitur prej nëpunësit \*\*\*\*\* , për verifikimin e ligjshmërisë të vendimit nr. 33, datë 01.09.2020, “Për lirimin nga shërbimi civil i nëpunësit civil \*\*\*\*\*”, nga Kryetari i Bashkisë Maliq*”, është vënë në dijeni institucioni i Bashkisë Maliq për fillimin e verifikimit të rastit, duke kërkuar njëkohësisht

dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij, i cili është dërguar me shkresën protokolluar me nr. 47/1 prot., datë 21.01.2021, “*Kthim përgjigje*”.

Duke shqyrtuar përmbajtjen e akteve administrative të vëna në dispozicion nga Bashkia Maliq, rezulton e vërtetuar se nëpunësi \*\*\*\*\*\*, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me aktin e emërimit nr. 2650 prot., datë 06.07.2018, të njësisë së burimeve njerëzore, është emëruar “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin e punës “*Nëpunës Auditi*”, në Bashkinë Maliq dhe më pas, në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 3506 prot., datë 14.08.2019, ai është konfirmuar si nëpunës civil.

Bazuar në ligjin nr. 114/2015, “*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*”, në nenin 11, “*Punësimi i Audituesit të Brendshëm*”, pika 2, germa (ç), citohet shprehimisht se, “*Punonjësi që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtëpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjësi duhet t’i nënshtrohet detyrimit të procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm”. Në rast se, brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm”, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji. Brenda periudhës dy vjeçare punonjësi duhet ti nënshtrohet detyrimit të procedurës së certifikimit si Auditues i Brendshëm”.*

Nisur nga detyrimi i mësipërm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Ligjore në Bashkinë Maliq, me shkresën nr. 3042 prot., datë 07.08.2018, “*Kërkim informacioni mbi certifikimin e punonjësve të auditit*”, i është drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet të cilës, bazuar në ligjin nr. 114/2015, “*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*”, ka kërkuar informacion në lidhje me mundësinë e certifikimit të nëpunësit \*\*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Nëpunës Auditi*”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Maliq.

Drejtorja e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në rolin e njësisë përgjegjëse për certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik, me shkresën nr. 15049/1 prot., datë 14.08.2018, “*Kthim përgjigje*”, ka sqaruar institucionin e Bashkisë Maliq se, bazuar në germën ç) të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 114/2015, “*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*”, si dhe kriteret e përcaktuara në Urdhrin nr. 162, datë 29.05.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “*Për fillimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për sezonin 2018-2019*”, procesi i regjistrimit të kandidatëve të cilët janë kualifikuar për të ndjekur këtë proces të certifikimit, për sezonin e vitit 2018-2019, ka përfunduar e për këtë arsye, nëpunësi \*\*\*\*\*\*, duhet të ndjekë mundësinë e regjistrimit në procesin e certifikimit për sezonin e ardhshëm 2019-2020.

Nisur nga sugjerimi i mësipërm dhe në respektim të afatit ligjor 2 vjeçar, nëpunësi \*\*\*\*\* , nëpërmjet postës elektronike (*e-mail*) që mban datën 17.06.2019, i është drejtuar individualisht Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duke kërkuar informacion në lidhje me mënyrën, afatet dhe procedurat e regjistrimit për certifikimin si auditues i brendshëm, për periudhën 2019-2020.

Rezulton se Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, i ka kthyer përgjigje në datën 15.07.2019, ende brenda afatit 2 vjeçar, ku e ka informuar nëpunësin në fjalë se, në momentin e shpalljes së urdhrimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për fillimin e procesit të regjistrimit për kryerjen e kursit përkatës, për certifikimin si auditues i brendshëm, do të njoftohet zyrtarisht njësia e burimeve njerëzore e institucionit Bashkia Maliq dhe përveç kësaj, ky njoftim do të jetë i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. *Pra, siç shihet, nëpunësi në fjalë ka treguar interesimin e nevojshëm dhe vonesat në asnjë rast, nuk kanë ardhur për shkak të neglizhencës së tij.*

Ndërkohë që nëpunësi në fjalë ka vazhduar kryerjen e detyrës së tij si auditues i brendshëm dhe ishte në pritje të çeljes së regjistrimeve për kryerjen e kursit të certifikimit, në datën 07.11.2019, Njësia Administrative Pojan, ka paraqitur një kërkesë pranë Bashkisë Maliq, nëpërmjet të cilës, për nevoja të ngutshme të punës, ka kërkuar plotësimin e pozicionit “*Specialist Finance/Protokoll*”.

Nisur nga kjo kërkesë, njësia përgjegjëse e Bashkisë Maliq, pasi ka analizuar kërkesën e mësipërme dhe pasi verifikoi kërkesat e posaçme të vendit të punës dhe konkretisht të llojit të diplomës, për shkenca ekonomike, si dhe kategorizimin e pagës për këtë pozicion pune që ishte, kategoria ekzekutive IV-a, arriti në përfundimin se, nëpunësi i auditit të brendshëm \*\*\*\*\* , i plotësonte kushtet për mbajtjen e pozicionit të punës “*Specialist Finance/Protokoll*”, në Njësinë Administrative Pojan dhe për këtë arsye, bazuar në vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për tranfesimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, me urdhrin nr. 454, datë 13.11.2019 “*Për transferim punonjësi*”, e ka transferuar atë, *me afat kohor të pa përcaktuar*, në pozicionin e punës “*Specialist Finance/Protokoll*”, në Njësinë Administrative Pojan, pozicion i cili, është jashtë shërbimit civil.

Më pas, njësia përgjegjëse dhe drejtuesi i Bashkisë Maliq, pasi kanë konstatuar plotësimin e afatit dy vjeçar, brenda të cilit nëpunësi \*\*\*\*\* , kishte detyrimin e certifikimit si Auditues i Brendshëm, përcaktuar në ligjin nr. 114/2015, “*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*”, me aktin nr. 33 dt. 01.09.2020 të kryetarit të Bashkisë, është urdhëruar përfundimi i afatit të transferimit të përkohshëm të tij, në pozicionin e punës “*Specialist Finance/Protokoll*”, në Njësinë Administrative Pojan (*megjithëse kishin kaluar 10 muaj, pra më shumë se afati maksimal 6 muaj*), duke vendosur rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës “*Nëpunës Audit*”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Maliq, e në të njëjtën kohë, bazuar në nenin 11, “*Punësimi i Audituesit të Brendshëm*”, pika 2, germa (ç), të ligjit nr. 114/2015, “*Për Auditimin e Brendshëm në*

*Sektorin Publik*”, në mungesë të certifikatës së auditit, ka urdhëruar përfundimin e marrëdhënies së në shërbimin civil për nëpunësin civil \*\*\*\*\*”, me arsyetimin se nuk ka përmbushur kriteret e pozicionit të punës “*Nëpunës Auditit*”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Maliq.

Pasi është liruar nga shërbimi civil, nëpunësit në fjalë, me urdhrin nr. 426, datë 01.10.2020, “*Për emërim punonjësi*”, të Kryetarit të Bashkisë Maliq, i është ofruar mundësia e punësimit në pozicionin e punës “*Specialist Inspektor Tatimor*”, në Njësinë Administrative Pojan, të Bashkisë Maliq, marrëdhënie kjo e bazuar në nenin 64, germa (g), të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, pozicion i cili gjithashtu, nuk është pjesë e shërbimit civil. Në raport me këtë emërim, rezulton se nëpunësi në fjalë, me shkresën nr. 4820 prot., datë 05.10.2020, “*Refuzim emërimi sipas urdhrit të emërimit*” ka shprehur refuzimin e tij, me pretendimin se është larguar pa të drejtë nga shërbimi civil dhe i është ofruar një vend pune jashtë këtij shërbimi.

Megjithë pretendimet e mësipërme të nëpunësit \*\*\*\*\* , Administratori i Njësisë Administrative Pojan, me shkresën nr. 600/2 prot., datë 26.10.2020, “*Njoftim mbi mosparaqitjen në punë*”, ka njoftuar institucionin e Bashkisë Maliq se, punonjësi në fjalë nuk është paraqitur në punë, nga data 01.10.2020 deri në datën 22.10.2020 dhe nuk ka paraqitur shkaqe të arsyeshme për këto mungesa, megjithëse shkakun i mosparaqitjes ishte deklaruar prej nëpunësit në fjalë.

Mbi këtë bazë, Kryetari i Bashkisë Maliq, bazuar në nenin 64, germa (g), të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, me aktin nr. 491, datë 28.10.2020, “*Për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës*”, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës për nëpunësin \*\*\*\*\* , si “*Specialist Inspektor Tatimor*”, pranë Njësisë Administrative Pojan.

Nga analiza e zhvillimeve të mësipërme, konstatohet se në trajtimin e këtij rasti, nga ana e Njësisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Maliq, janë kryer e lejuar një sërë shkeljesh të regjimit të legjislacionit të shërbimit civil, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt, në mbarëvajtjen e marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësit \*\*\*\*\*.

*Së pari*, transferimi për nevoja të institucionit, i kryer me urdhrin nr. 454, datë 13.11.2019 “*Për transferim punonjësi*” të kryetarit të Bashkisë Maliq, për një periudhë të pa përcaktuar, nga pozicioni i tij i punës “*Nëpunës Auditit*”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Maliq, në pozicionin e punës “*Specialist Finance/Protokoll*”, në Njësinë Administrative Pojan, (pozicion i cili nuk është pjesë e shërbimit civil), nga data 13.11.2019, deri në datën 01.09.2020, pra për një periudhë prej rreth 10 muaj, është një veprim administrativ i kryer në kundërshtim me përcaktimet e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, i cili kërkon si kusht që, në rastet e transferimit të përkohshëm të një nëpunësi civil, për ato raste që parashikon dispozita në fjalë, të respektohet kategoria e punësimit të tij në shërbimin civil dhe koha e transferimit të

përkohshëm, nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj gjatë 2 viteve. Në rastin konkret, nuk është respektuar as kushti i ruajtjes të kategorisë së pozicionit të punës, pasi ai është transferuar në një pozicion pune *që nuk është pjesë e shërbimit civil* dhe as afati maksimal i transferimit të përkohshëm. Të dy këto shkelje, janë arsye që në aktin nr. 454, datë 13.11.2019 “*Për transferim punonjësi*” të kryetarit të Bashkisë Maliq të evidentohen këta elementë të dukshëm paligjshmërie, që përbëjnë shkak për anulimin e tij.

*Së dyti*, duke vepruar si më sipër, njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Maliq, ka shkelur kushtet e Udhëzimit nr. 7, datë 16.03.2016, të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave “*Për miratimin e rregullores për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar, sipas të cilit, bazuar në nenin 9, pika 2, germa c), të këtij udhëzimi kërkohet në mënyrë të shprehur që, në momentin e regjistrimit të kandidatëve për fillimin e procesit të certifikimit si auditues i brendshëm në sektorin publik, *ata duhet të jenë të punësuar pa ndërprerje, në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik.*

Në kushtet e transferimit të kundraligjshëm, për të cilin u fol hollësisht në pikën e mësipërme të këtij vendimi, nëpunësit \*\*\*\*\* , edhe sikur të ishim në kushte normale dhe ai do të kërkonte të regjistrohej në kursin për të marrë certifikatën, kjo mundësi do ti refuzohej gjatë procesit të seleksionimit nga ana e organizmit përkatës, pikërisht sepse ai kishte një ndërprerje 10 mujore, nga puna si audit i brendshëm. Pra ky shkak, i krijuar nga veprimet e paligjshme të njësisë së burimeve njerëzore dhe drejtuesi i Bashkisë Maliq, gjithashtu i pavarur nga vullneti i nëpunësit, do të ishte bërë pengesë ligjore për regjistrimin e tij, edhe sikur procesi të kishte vazhduar, pa ndërprerjen prej pandemisë Covid 19.

Nisur nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se do të ishte pa vend penalizimi i nëpunësit \*\*\*\*\* , nga veprimet e parregullta të organeve që kanë për detyrë menaxhimin e shërbimit civil, prandaj, pavarësisht mangësive dhe pengesave për të cilat u renditën më sipër, atij duhet ti jepet mundësia që të aplikojë për të marrë certifikatën e auditit, sapo të fillojnë regjistrimet për sezonin e ardhshëm.

*Së treti*, i paligjshëm është edhe shkak i që është përdorur për lirimin nga shërbimi civil dhe shkëputjen e marrëdhënieve të punës, të nëpunësit \*\*\*\*\* , se brenda afatit dy vjeçar, nga momenti i fillimit të marrëdhënies në shërbimin civil, nuk ka mundur të sigurojë certifikatën si “*Auditues i Brendshëm*”.

Me qëllim sqarimin e faktit, nëse nëpunësi \*\*\*\*\* , për neglizhencë apo për shkaqe të pavarura prej tij, nuk ka marrë pjesë, brenda afatit dy vjeçar, në kurset e organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave, në datën 05.01.2021, u kërkua informacion zyrtar nga njësia e mësipërme, në lidhje me procedurën dhe ecurinë e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm publik për sezonin 2019-2021.

Nga përmbajtja e përgjigjes zyrtare të institucionit të mësipërm, rezulton e vërtetuar se, në kushtet e situatës të shkaktuar nga pandemia COVID-19, dhe veprimet të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me Urdhrit nr. 65/1, datë 01.04.2020, “Për një ndryshim të urdhrin nr. 65, datë 06.03.2020”, ka urdhëruar ndryshimin e pikës 6, të këtij urdhri, duke përcaktuar që afati i pranimit të dokumentacionit nga kandidatët për certifikim për audit të brendshëm, të shtyhet për një afat të pacaktuar.

Nga komunikimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, sqarohet se ky urdhër për shtyrjen e aftatit të aplikimit të kandidatëve, për një kohë të pacaktuar, i është njoftuar (me e-mail), çdo drejtuesi të Njësive të Auditëve të Brendshëm pranë njësive publike, përfshirë këtu dhe njësinë e menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Maliq, duke ju sjellë në vëmendje, njoftimin e e këtij urdhëri për çdo auditues të brendshëm, të interesuar për këtë proces.

Në vijim të sa më sipër, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave, ka njoftuar se me Urdhrit nr. 65/2, “Për një ndryshim të urdhrin nr. 65, datë 06.03.2020”, të ndryshuar, në pikën 1 të tij, është përcaktuar që afati i pranimit të dokumentacionit, për kandidatët që aplikojnë për audit të brendshëm për sezonin e ardhshëm, do të jetë data 06.11.2020.

Nga gjithë sa u thanë më sipër, arrihet në përfundimin se nëpunësi \*\*\*\*\* , për asnjë çast nuk ka neglizhuar në përpambushjen e detyrimeve ligjore që lidheshin me punësimin e tij si specialist i auditit të brendshëm në Bashkinë Maliq. Efektivisht, ky nëpunës, megjithë vullnetin pozitiv, që ka treguar për plotësimin e këtij kushti, ka qenë në pamundësi objektive për ta marrë certifikatën e kërkuar, pasi për gjithë periudhën 2019, deri në datën 06.11.2020, nuk është zhvilluar asnjë kurs kualifikimi për paisjen e të interesuarve me certifikatën e auditit të brendshëm dhe sapo është krijuar mundësia, rezulton se ka aplikuar në datën 21.01.2021, në Drejtorinë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave, në sezonin e rradhës.

Përkundrazi, kanë qenë mosveprimet apo veprimet e kundraligjshme, të njësisë së burimeve njerëzore dhe të drejtuesit të Bashkisë Maliq, që kanë krijuar pengesa në plotësimin e detyrimeve ligjore nga ana e këtij nëpunësi, e kombinuar kjo dhe me kushtet dhe pengesat e jashtzakonshme të krijuara nga pandemia Covid 19.

Në kushte të tilla, pamundësia e pjesëmarrjes së nëpunësit në fjalë, në kursin e certifikimit për auditues të brendshëm e për rrjedhojë mosplotësimin e kushtit për të mbajtur pozicionin e punës “audit i brendshëm” në Bashkinë Maliq, duhet të konsiderohet si pamundësi pjesëmarrje, për shkaqe të arsyeshme, objektive dhe koha e kaluar për shkak të *Pandemisë Covid-19*, duhet të konsiderohet si një pezullim i ecjes së aftatit, të parashikuar, brenda të cilit duhej të ishte përfunduar certifikimi si audit i brendshëm, për shkaqe madhore,

të pavarura jo vetëm nga vullneti i nëpunësit në fjalë, por dhe nga vullneti i gjithkujt (në analogji kjo, me rastin e pezullimit të afatit të parashkrimit, për arsye madhore, që parashikohet në nenin 129, germa “ë” të Kodit Civil të RSH”).

Në këtë vështrim, shkak i parashtruar në vendimin nr. 33, datë 01.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë Maliq, “Për lirimin nga shërbimi civil, i nëpunësit civil \*\*\*\*\*”, vjen në kundërshtim me zhvillimin e rrethanave në realitet dhe me përmbajtjen apo qëllimin e ligjit material, pasi nëpunësi në fjalë, është vënë në kushte të disfavorshme dhe është penalizuar, për shkaqe të pavarura prej tij.

Në rastin konkret, organi publik kishte detyrimin që, duke vlerësuar me objektivitet rrethanat që determinuan pamundësinë e aplikimit të nëpunësit në fjalë, për paisjen me certifikatën e auditit të brendshëm, nuk duhej të urdhërontë ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, bazuar në nenin 11, “Punësimi i Audituesit të Brendshëm”, pika 2, germa (ç), të ligjit nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, por në bazë të neneve 54 e 55, të ligjit nr. 44/2015, ta orientonte nëpunësin që të paraqiste një kërkesë për rivendosje në afat dhe të vendoste rivendosjen në afat, duke i dhënë mundësinë atij të aplikonte dhe të merrte pjesë në kursin e rradhës që do të organizohej nga organi kompetent.

Nisur nga gjithë sa është parashtruar më sipër, arrihet në përfundimin se, akti nr. 33, datë 01.09.2020, i Kryetarit të Bashkisë Maliq, “Për lirimin nga shërbimi civil, i nëpunësit civil \*\*\*\*\*”, është nxjerrë në kushtet e ushtrimit të diskrecionit në mënyrë jo të ligjshme dhe në shkelje të ligjit material, prandaj në bazë të nenit 109, pika “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, ai duhet të anulohet si akt i paligjshëm, nga vetë organi publik që e ka nxjerrë, me një akt të ri me shkrim. Në këtë akt duhet të merren edhe masat për rregullimin e pasojave që ka sjellë ky akt i paligjshëm, duke konfirmuar pezullimin e afatit të paisjes me certifikatën e auditit të brendshëm, për gjithë periudhën që për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19, pasi ka qenë i pamundur organizimi dhe funksionimi i kurseve për pajisjen me këtë certifikatë, nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave.

### **Për këto arsye:**

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neneve 54 e 55, pikave “d” dhe “dh” të nenit 109 dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH” dhe neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

## VENDOSA:

1. Organi publik, Kryetari i Bashkisë Maliq, të anulojë si të paligjshëm, aktin administrativ nr. 33, datë 01.09.2020, për lirim nga shërbimi civil të nëpunësit \*\*\*\*\* , me një akt të ri me shkrim, për shkak se përbën ushtrim të diskrecionit në mënyrë jo të ligjshme dhe se vjen në kundërshtim me përmbajtjen e ligjit material e atij procedural.
2. Për rregullimin e pasojave të ardhura nga akti i paligjshëm, të urdhërohet rikthimi i nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin e tij të mëparshëm të punës “*Nëpunës Auditit*”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Maliq, duke i sugjeruar nëpunësit në fjalë, të bëjë një kërkesë për rivendosje në afat, kërkesë e cila duhet të shqyrtohet dhe të pranohet, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes (*pika 1, e nenit 55, të ligjit 44/2015*), duke i krijuar atij mundësinë për të marrë pjesë në kursin e specializuar për tu pajisur me certifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik.
3. Depozitimi i kërkesës, (*sipas pikës 2, të nenit 55, të ligjit 44/2015*) shkakton pezullimin e të gjitha veprimeve procedurale të kryera si pasojë e humbjes së afatit.
4. Ky vendim duhet të zbatohet brenda afatit 20 ditor, nga momenti i komunikimit të tij.
5. Me kalimin e këtij afati, institucioni Bashkia Maliq, është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me mënyrën e veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**